



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Akademia e Sigurisë

Adresa: Rruga e Elbasanit, Sauk – Tiranë;

Telefon +355 4 235 4932

Nr. 2066 Prot.

Tiranë, më 9.9.2025

THIRRJE PËR PJESËMARRJE
NË KONFERENCËN XI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"FORCIMI I PROCESVEVE TË INTEGRIMIT NDËRMJET POLICISË
SHKENCORE, PRAKTIKËS POLICORE,
DHE INTELIGJENCËS ARTIFICIALE"
TË AKADEMISË SË SIGURISË
TIRANË, 17 DHJETOR 2025

Akademia e Sigurisë ka kënaqësinë të njoftojë zhvillimin e konferencës së saj XI shkencore ndërkombëtare, më 17 dhjetor 2025, me temë: **Forcimi i proceseve të integrimit ndërmjet policisë shkencore, praktikës policore, dhe inteligjencës artificiale (IA).**

Konferenca do të shërbejë si një forum akademik dhe praktik për të analizuar, diskutuar dhe promovuar mënyrat më efikase të integrimit të zhvillimeve të reja teknologjike në fushën e sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

Tematika e mundshme orientuese:

1. Siguria dhe hetimi i krimit, mundësuar nga IA-ja: sfidat e së ardhmes.
2. IA, zbulimi dhe parandalimi i krimit nga Policia e Shtetit.
3. IA në policim: ndërlidhja e teknologjisë me zbatimin e ligjit.
4. Ndikimi i IA-së në siguri, polici shkencore dhe praktikë policore.

TIPI I KONFERENCËS

Konferencë shkencore ndërkombëtare, me audiencë të gjerë nga akademja, praktika policore, sektori privat dhe organizatat ndërkombëtare. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të prezantojnë punime shkencore, të diskutojnë praktika dhe të krijojnë ura bashkëpunimi për projekte të ardhshme.

PJESËMARRËSIT

Konferenca është e hapur për:

- stafin akademik dhe studentët e Akademisë së Sigurisë;
- ekspertë e studiues nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit;
- akademikë nga institucionet publike dhe private të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit;
- studiues dhe ekspertë të inteligjencës artificiale, teknologjisë dhe sigurisë nga vendet partnere;
- përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë, kompanive teknologjike dhe qendrave kërkimore.

DATA TË RËNDËSISHME

30 shtator 2025: Afati i fundit i dorëzimit të abstrakteve.

20 nëntor 2025: Afati i fundit i dorëzimit të punimeve të plota (pas konfirmimit).

Punimet dërgohen në adresën: kerkimeshkencor.as@gmail.com
dhe akademiaesigurise01@gmail.com

FOKUSI I KONFERENCËS

Në epokën digjitale, ku inteligjenca artificiale po transformon shoqërinë, policia moderne përballlet me nevojën urgjente për t'i integruar këto zhvillime në të gjitha nivelet e saj. Konferenca do të fokusohet tek:

- përdorimi i algoritmeve dhe analizës së të dhënave të mëdha (*big data*) në parandalimin dhe zbulimin e krimit;
- zbatimi i teknologjive të njohjes së modeleve dhe inteligjencës vizuale në hetimin forenzik;
- roli i IA në sigurinë kibernetike dhe policim;
- integrimi i etikës, privatësisë dhe të drejtave të njeriut në përdorimin e IA-së për policim, hetim dhe në siguri publike.

Ne synojmë të krijojmë një platformë për shkëmbimin e eksperiencave ndërmjet teorisë akademike dhe praktikës operative, duke u fokusuar në zhvillimin e një policie inteligjente që kombinon ekspertizën njerëzore me kapacitetet e përparme teknologjike. Diskutimet do të përqendrohen në krijimin e një ekosistemi të integruar ku kërkimi shkencor informon praktikën, praktika informon zhvillimin teknologjik, dhe teknologjia mbështet si kërkimin ashtu dhe zbatimin operacional.

OBJEKTI DHE QËLLIMI

Objekti kryesor i kësaj konference është analiza e thelluar e mënyrave të integrit të tre komponentëve kyç të policimit modern: dimensionin shkencor që siguron bazën teorike dhe metodologjike, praktika operative që siguron zbatimin në terren, dhe inteligjenca artificiale që ofron mjetet e avancuara teknologjike për optimizimin e të dyjave.

Konferenca synon:

Teorikisht: të zhvillojë korniza konceptore për integrimin midis policisë shkencore, praktikës policore, policimit dhe IA-së.

Praktikisht: të evidentojë modele suksesi nga praktika ndërkombëtare në përdorimin e IA-së për sigurinë publike.

Teknologjikisht: të eksplorojë zgjidhje inovative dhe aplikime konkrete të IA-së në siguri dhe policim.

SYNIMI I KONFERENCËS

Analizimi i gjendjes aktuale të integritetit të teknologjisë dhe praktikës policore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Identifikimi i sfidave teknike, ligjore, etike dhe financiare në gërshetimin e policimit me IA.

Prezantimi i rasteve studimore dhe praktikave të mira nga vende të ndryshme.

Hartimi i rekomandimeve konkrete për përmirësimin e proceseve të gërshetimit të IA-së në sferën e sigurisë.

Krijimi i rrjeteve të bashkëpunimit akademik e profesional.

Projekte strategjike për policinë e së ardhmes.

STRUKTURA E KONFERENCËS

Sesioni I – IA, bazat teorike dhe metodologjike

- Kornizat teorike të policimit, policisë shkencore dhe IA në epokën digjitale.
- Metodologjitë e kërkimit për teknologjitë e reja policore.
- Standardet ligjore dhe etike për përdorimin e IA.
- Privatësia, të dhënat dhe siguria e informacionit.
- Psikologjia organizuese në adoptimin e teknologjive të reja.
- Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve për policinë inteligjente.

Sesioni II – Zbatime praktike dhe raste studimore

- Përdorimi i IA në analizat forenzike dhe hetime.
- Algoritmet e parashikimit të krimit: mundësitë dhe rreziqet.
- Teknologjitë biometrike dhe identifikimi inteligjent.
- Dronët, robotika dhe automatizimi në operacionet policore.
- Monitorimi inteligjent dhe analiza e videove në kohë reale.
- IA në luftën kundër krimit kibernetik dhe financiar.
- Platformat e integritetit të të dhënave për bashkëpunim ndërinstitucional.

Sesioni III – Sfidat dhe perspektivat e ardhshme

- Integrimi i sistemeve të ndryshme të IA në polici.

- Kostot dhe përfitimet e investimeve në teknologjitë e reja.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe standardizimi i IA për policinë.
- Roli i sektorit privat dhe *start-up*-eve në inovacionin policor.
- Përgatitja policore për teknologjitë emergjente në: *Blockchain, IoT, Quantum Computing, Smart City*.
- Skenarë të policisë të së ardhmes dhe vizione strategjike për sigurinë.

PËRFITIME PËR PJESEMARRËSIT

Publikim i punimeve të përzgjedhura në buletin shkencor të Akademisë së Sigurisë.

Mundësi për bashkëpunime kërkimore ndërkombëtare.

Krijim lidhjesh (*networking*) me ekspertë dhe kompani teknologjike.

Rektori i Akademisë së Sigurisë
Prof. Ilirjan Mandro

Konc. Dr.proc Anisa Hysesani